



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

RAPORT VENDIMMARRJE

Fushe-Arrez, me 24.12.2025

Nr 4039/Prot



Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 35 datë 14/11/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Mbi miratimin e Paketes Fiskale për vitin 2026"

Analiza ligjore: Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vatëqeverisjen vendore", në mbështetje të nenit 54 gërma "f", nenit 55 pika 3, të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar Në ligjin nr. 10081/2009 "për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr.10304 datë 15.07.2010 "Për Sektorin minerar Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr.9975 datë 28.07.2008 "Për taksën kombëtare", i ndryshuar, ligji nr. 152/2015 "Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", VKM nr.607 datë 29.07.2020 "Për tarifatat dhe llojet e sherbimeve që ofrohen nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" si dhe Nr. 132, datë 7.3.2018 "për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar.

Situata aktuale e funksionit dhe parashikimi financiar: Në paketën fiskale për vitin 2026 paraqiten riklasifikime të taksave dhe tarifave ekzistuese, prezantimi i tarifave të reja, përcaktimi i qartë i llojit të taksave/tarifave, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese si dhe strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre.

Të gjitha ndryshimet do të shërbejnë si instrument për rritjen e eficensës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Vlen të theksohet që për vitin 2026 nuk do të ketë rritje Taksash për banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz dhe do ruajnë nivelin e vitit 2025.

PLANI I TË ARDHURAVE VENDORE PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMI 2027-2028																	000/lekë	
Nr.	Emertimi	V. 2026	V. 2027	V. 2028	Ndarja mujore													
					M/1	M/2	M/3	M/4	M/5	M/6	M/7	M/8	M/9	M/10	M/11	M/12		
I TË TRASHËGUARA																		
1	Taksa mbi pasurinë	6,129	6,125	6,125	510	511	511	510	510	511	510	510	511	510	510	511		
-	Taksa mbi ndertuesin	2,700	2,700	2,700	225	225	225	225	225	225	225	225	225	225	225	225		
-	Taksa mbi tokën	1,625	1,625	1,625	135	135	135	135	135	135	135	135	135	135	135	135		
-	Taksa mbi trashigimin	1,800	1,800	1,800	150	150	150	150	150	150	150	150	150	150	150	150		
2	Taksë fletje në hotel	20	20	20	2	2	2	2	2	2	2	2	2	1	1	1		
3	Taksë e ndikimit në infrastrukturë	100	100	100	8	9	9	8	9	9	8	8	9	8	8	8		
4	Taksë parkingu	60	60	60	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4		
5	Taksë vjetore qarkullimi mjeteve të përdorura	3,600	3,600	3,600	300	300	300	300	300	300	300	300	300	300	300	300		
6	Taksë nga renta minierare	2,000	2,000	2,000	167	167	166	166	167	166	166	167	167	167	167	167		
7	Tarifë pastrimi	4,000	4,000	4,000	333	334	334	333	333	333	334	333	333	332	334	333		
-	Tarifë pastrimi Familjet	300	300	300	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25	25		
-	Tarifë pastrimi Institucionet	700	700	700	58	59	59	58	59	59	58	58	59	58	58	57		
-	Tarifë pastrimi Bizneset	3,000	3,000	3,000	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250	250		
8	Tarifë Ndërimi	435	435	435	36	35	37	35	37	36	36	36	37	36	35	38		
-	Tarifë Ndërimi Familjet	50	50	50	4	4	4	5	5	4	5	4	4	6	4	4		
-	Tarifë Ndërimi Institucionet	150	150	150	13	13	13	12	12	13	13	13	12	12	12	12		
-	Tarifë Ndërimi Bizneset	235	235	235	19	19	20	19	20	20	20	19	19	20	20	20		
9	Tarifë leje Transporti	450	450	450	37	38	37	38	38	37	38	38	37	37	37	38		
10	Tarifë për Leje Ndërtimi	700	700	700	58	58	58	58	58	58	58	58	58	58	58	58		
11	Taksa të tjera të Ngjashme (Tarifë/Taksa)	100	100	100	8	9	9	8	9	9	8	8	9	8	8	8		
12	Te ardhura nga shitja e dru zjarri dhe Ad.Pyjore	1,600	1,600	1,600	133	133	133	134	133	133	133	133	133	133	134	134		
13	Tarifë e zënave të hapësirave publike	150	150	150	13	13	12	12	14	13	12	13	13	12	13	12		
14	Te ardhura nga kopshtet	410	410	410	34	34	34	34	34	34	34	34	34	34	34	34		
15	Te ardhura nga Cerdhet	210	210	210	15	15	15	20	20	20	20	25	25	10	10	10		
16	Te ardhura nga qerarte	5,300	5,300	5,300	441	442	442	442	441	442	441	443	441	441	442	442		
17	Te ardhura të tjera (Grande/Sponsorizime)	100	100	100	8	9	9	8	9	9	8	8	9	8	8	8		
18	Te ardhura nga Gjebo	100	100	100	8	9	9	8	9	9	8	8	9	8	8	8		
19	Te ardhura nga T.F.TH	50	50	50	4	4	4	5	5	5	5	4	6	4	4	4		
20	Te ardhura nga TAP	2,150	2,150	2,150	179	179	179	179	180	179	179	179	179	179	179	180		
21	Te ardhura nga leje Karburanteve	800	800	800	67	67	67	67	66	66	67	66	67	67	66	67		
22	Te ardhura nga MNZSH	27	27	27	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2		
23	Te ardhura nga qera Tole Buqetore	68	68	68	5	6	6	6	6	5	5	6	6	5	5	6		
II	TE ARDHURAT VENDORE TOTAL	28,555	28,555	28,555	2,371	2,379	2,376	2,381	2,389	2,384	2,389	2,385	2,391	2,389	2,369	2,373		
TOTALI I TË GJITHË		28,555	28,555	28,555	2,371	2,379	2,376	2,381	2,389	2,384	2,389	2,385	2,391	2,389	2,369	2,373		

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës dhe Sektori i të ardhurave ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimet dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Sektorin e të ardhurave për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Paketa Fiskale për vitin 2026 impakton jetën e gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkise.

Për hartimin e Paketës fiskale janë mbajtur degjesa publike në njesite administrative. Te gjithë dokumentet mbi degjesat janë të publikuara në faqen web të Këshillit Bashkiak.

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 24/12/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 35 datë 14/11/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Mbi miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026", paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Frone Doda  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Besiana Marku  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 4039 Prot.

Fushe-Arrez, me 24.12.2025

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

**Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbikqyrjes Financiare
Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit per PËR
MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2026**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mblodh sot, me 24.12.2025, Komisioni i Ekonomise Finances Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare. I pranishem ishte, Pergjegjesi i Zyres Tatim Taksave, z. Vilson Prenga i cili dha shpjegime per projektin qe do te shqyrtohet ne kete mbledhje.

Pergjegjesi i Zyres Tatim Taksave Z.Vilson Prenga, tha se projekti eshte i hartuar mbi baze te plote ligjore dhe se eshte i shoqeruar me relacionin shpejgues dhe paketen me te cilen anëtarët e Komisionit janë njohur përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Fushë-Arrëz.. Ai shtoi se kjo pakete e vitit 2026 eshte e perbere nga taksat dhe tarifat vendore te destinuara per juridiksionin e kesaj bashkie.

Te gjitha ndryshimet do te sherbejne si instrument per rritjen e eficenses administrative, profesionale dhe teknike te qeverisjes vendore, nepermjet rritjes te se ardhurave, per te ofruar sherbime me te mira per qytetaret, ku nder te tjera ai shtoi se Paketa Fiskale per vitin 2026 nuk do te kete ndryshime, te vetmet ndryshime jane shenimet mbi termat ligjore e nenligjore per taksat e pasurise se paluajtshme. Termat jane pershtat sipas ligjit. Eshte bere permiresimi I bazes ligjore nga fq 9 deri tef q 19. Gjithe paketa eshte pershtat sipas udhezimeve e ligjit.

Pasi beri nje shpjegim shume te qarte per projekt vendimin "Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2025", Z.Vilson Prenga kerkoi nga ana e anetareve te komisionit, qe te shprehnin paqartesite e tyre ne lidhje me kete projekt vendim.

Fran Doda Kryetar i komisionit pyet: Sa jane taksat per ndertesat e banimit? A jane mbledh taksat dhe kush mbedh? A keni inspektor taksash? A i paguan taksat Ujesjellesi? Ku arketohen leket qe mblidhen per shitesit abonente ditor neper qytet?

Pergjegjesi i Zyres Tatim Taksave Z.Vilson Prenga pergjigjet duke thene se kjo takse shkon 0.05%. Taksat jane mbledhe dhe tejkalu per vitin qe po leme pas. Sa i perket ujesjellesit ua kemi derguar faturat per ndertesën por nuk jane pergjigj. Taksat i mbledh policia Bashkiake.

Fran Doda, Kryetar i komisionit: Eshte fryre organika e punonjesve te emeruar ne pune, dikush punon shume e dikush aspak. Performanca e punonjesve ne kendveshtrimin tim nuk eshte e kenaqshme, une do propozoj per shkurtim te vendeve te punes te atyre qe nuk dine se çfare bejne.

Anetaret e komisionit shprehen se jane te kenaqur me zbritjen e takses se ndertimit te bere qysh vjet, pasi ka qene nje taske e larte per banoret.

Me shumice votash, anetaret e komisionit rane dakord me projektvendimin, duke e derguar per shqyrtim te metejshem ne mbledhjen e dates 26.12.2025.

PER KOMISIONIN

FRANC DODA

Zef Cere
Valentina Lleshaj

Lin! Ert
byj

Beriana Marku
Bj